



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE**

Nr.1759 Akti
Dt. Regj 09.10.2015.

Nr . 1630 Vendimi
Date 23.11.2015

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Sot me date 23.11.2015, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretaria gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 1759 akti date 09.10.2015 qe i përket:

PADITES: Elda Sinjari, person fizik, me nr. L44202401C nipti, me adresë në rrugën “Bajram Haxhiu”, lagjia “Kongresi”, kati i parë, Lushnjë, perfaqesuar nga Av. Brixhilda Sinjari.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me adresë në rrugën “ Brigada e 11-të Sulmuese”, lagjia “Apollonia”, Fier, perfaqesuar nga Ervisa Shabanaj.

PERSON I TRETE: Zyra Vendore e Avokatit te Shtetit Vlore, ne mungese.

OBJEKTI: Shfuqizimin pjesërisht të Procesverbalit të Konfiskimit me nr. 0014111, datë 09.09.2015 i cili ka vendosur konfiskim sipas Akt-Konstatimeve me nr. 0474851 dhe nr. 0474852, datë 09.09.2015 të inspektorëve të Sektorit të Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier si edhe kthimin e shumës në vlerën 386.950 lekë e llogaritur nga



Komisioni i Vlerësimit të Mallrave të Konfiskuara me Vendimin nr. 12326/1 prot., datë 10.09.2015.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimi i Mosmarrëveshjeve Administrative", Ligji Nr. 9920, Datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "Për Sistemin e taksave Vendore", i ndryshuar.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi dëgjoi paditësin i cili kërroi pranimin e padisë sipas objektit dhe te paditurin i cili kërroi rrëzimin e padisë dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi çështjen ne tërsi, si përfundim,

V E R E N

Se para Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlore pala paditëse Elda Sinjari paraqitur një padi me objekt si me sipër.

Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Gjykata çmon se është ne kompetencën lëndore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi padia është një prej atyre te parashikuara ne nenin 7 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Gjithashtu gjykata çmon se është ne kompetencën tokësore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11 te Ligjit Nr.49/2012 " Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", "Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë. 2. Paditë për marrëdhëniet e punësimit shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij. 3. Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm,



që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij”.

Ne rastin konkret pale e paditur eshte Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Nga provat e administruara ne seance gjyquesore rezulton se në ambjentin ku paditësja zhvillon aktivitetin Bar-Kafe është ushtruar kontroll, kontroll i cili ka filluar që prej orës 16.12 dhe ka përfunduar në orën 23.59.

Gjykata veren se nga kontrolli i kryer nuk u gjend asnjë parregullësi, fakt ky që provohet nga Akt – Konstatimet me nr. 0474851 dhe 0474852 paraqitur si provë përparrë gjykates. Gjykata verense siç pasqyrohet edhe në përbajtjen e tyre, u konstatua se subjekti:

është i pajisur me certifikatë regjistrimi nga QKR;

ka të instaluar pajisjen fiskale nga ku u mor dhe kupon tatimor;

të punësuarit janë të regjistruar dhe deklaruar në organet tatimore;

ka të afishuar posterin “merrni kuponin tatimor”;

ka të vendosur listën e çmimeve;

na paraqiti librat e shitjes dhe blerjes.

Nga inventari fizik i kryer nga inspektorët janë gjetur vetëm disa mallra me qëllim rishitje pa faturë, me vlerë 10.272 lekë, përkatësisht grodino, birrë paulaner, patatina, fanta dhe çaj san benedetto.

Gjate gjykimit u vertetua fakti se kjo ka ndodhur për shkak se furnitori nuk kishte cilësuar saktësisht markën e tyre ne fature.

Megjithatë, për sa i përket këtyre mallrave, të cilat janë objekt i veprimtarisë që paditësja ushtron në kuptim edhe të dispozitave të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka asnjë kundërshtim për konfiskimin e tyre (pagesa e bërë për riblerjen e tyre).

Nga ana tjetër në Akt-Konstatime janë përfshirë pajisjet dhe orenditë e lokalit, përkatësisht tavolinat, karriget dhe televizorët, me vlerë 386.950 lekë duke i konsideruar edhe ato si mallra pa dokument, bazuar në nenin 121, pika 1 të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore” i cili parashikon:

Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumentet e duhura tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore.

Gjykata veren se në rastin konkret, paditëses nuk i janë konfiskuar vetëm mallrat me qëllim rishitje, por edhe pajisjet dhe orenditë, aktivet gjëndje.



Gjithashtu në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, dalë në zbatim të Ligjit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në kreun XIV “Sanksionet”, për nenin 121, pika 1 theksohet se:

“Për zbatimin e këtij dënimini punonjësit e administratës tatimore duhet të evidentojnë me saktësi faktin që mallrat janë pa dokumentet e kërkuar ligjorë dhe gjykojnë se këto mungesa kanë shkaktuar ose kanë për qëllim shmangien e tatimeve, duke pasur parasysh edhe dispozitat e pikës 58 të këtij Udhëzimi.”

Gjithashtu, Udhezimi i Ministrise se Financave nr. 32, date 31.12.2013 qe ka dale per zbatim te Ligjit Nr. 9632, Datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar parashikohet se:

7. Mbajtja e regjistrimeve

7.1 Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit për çdo shitje të kryer janë të detyruar:

a) Të lëshojnë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh, faturë të thjeshtë tatimore për çdo blerës të tatushëm që merr furnizimin. Forma dhe përbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në shtojcën nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këta tatimpagues janë të detyruar të lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore edhe për çdo shitje mallrash e shërbimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitet e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme.

b) Tatimpaguesi që realizon një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit si shitës me pakicë, për çdo shitje në njësitet e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatorë finalë, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me pajisje fiskale dhe në mungesë të saj, dëftesë tatimore. Kuponi tatimor lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, janë të detyruar të pajisen me pajisje fiskale. Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit shitës me pakicë, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të cilët për arsyе objektive, si:

prishje e pajisjes fiskale apo mungesa e energjisë elektrike ose që, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, nuk janë të detyruar të pajisen me pajisje fiskale. Rolin e dëftesës tatimore/kuponit tatimor mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuar në akte të tjera ligjore apo nënligjore, si për shembull biletat e transportit të udhëtarëve.

c) Kuponi tatimor i lëshuar me arkë regjistruese (pajisje fiskale), si dhe dëftesa tatimore nuk mund të shërbejnë si dokumente justifikuese të shpenzimeve të


zbritshme të biznesit për blerësin, përveç rastit kur shoqërohen edhe me faturë të thjeshtë tatumore.

d) Tatimpaguesi, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për çdo lëvizje të brendshme të mallrave nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan, apo anasjelltas, nga vendi i prodhimit në magazinë apo nga vendi i prodhimit në dyqan, sipas përcaktimeve në ligjin për procedurat tatumore, është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit.

7.2. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, çdo blerje të tyre janë të detyruar ta justifikojnë me:

a) faturë tatumore me TVSH, kur blerja është kryer te personat e regjistruar si tatimpagues të TVSH-së.

b) faturë të thjeshtë tatumore, kur blerja është kryer te personat e regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe nuk janë tatimpagues të TVSH-së.

7.3. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, për shkeljet e kryera lidhur me dokumentacionin justifikues në shitje dhe në blerje, penalizohen sipas përcaktimeve të ligjit “Për procedurat tatumore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij.

7.4. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, janë të detyruar të mbajnë:

a) librin e shitjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo shitje të kryer me faturë të thjeshtë tatumore si dhe totalin e shitjeve ditore të kryer me kuponë tatumorë;

b) librin e blerjeve, ku regjistrojnë në mënyra kronologjike çdo blerje të kryer me faturë tatumore, me TVSH, me faturë të thjeshtë tatumore;

c) libri i shpenzimeve dhe të ardhurave;

d) librin e aktiveve të biznesit.

7.5 Forma dhe përbajtja e librit të shitjeve, librit të blerjeve, librit të shpenzimeve dhe të ardhurave, librit të aktiveve të biznesit, janë sipas formularëve përkatës, shtojcat nr 2, shtojca nr.3, shtojca nr.4, shtojca nr.5, shtojca nr.6 dhe shtojca nr.7, bashkëngjitur këtij udhëzimi,

7.6 Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që janë të regjistruar në TVSH, libri i shitjeve dhe libri i blerjeve të mbajtura përfshirë efekte të TVSH, shërbejnë si të tillë edhe përfshirë efekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

7.7 Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël me qarkullim vjetor deri në 2,000,000 lekë për çdo shitje të kryer janë të detyruar të lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore, kupon tatimor ose dëftesë tatimore. Ata janë të detyruar gjithashtu që çdo blerje të kryer ta justifikojnë me faturë tatimore me TVSH ose faturë të thjeshtë tatimore.

Gjate gjykimit u vertetua se subjekti Elda Sinjari, person fizik, është i regjistruar në QKR, deklaron rregullisht në Organet Tatimore dhe ka objekt të veprimtarisë “Bar-Kafe”, fakte këto që u konstatuan edhe gjatë kontrollit të ushtruar nga inspektorët e Sektorit të Zbatimit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Gjykata cmon se procesverbali i Konfiskimit i mbajtur nga inspektorët e Sektorit të Zbatimit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me nr. 0014111, datë 09.09.2015 i bazuar në nenin 121 të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në të cilin përfshihen edhe aktivet afatgjata të subjektit me vlerë 386.960 lekë, në fakt është akt i pabazuar në nenin 121 të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi ato nuk janë mallra me qëllim rishitje në kuptimin e veprimtarisë së subjektit Elda Sinjari, sepse objekti i veprimtarisë është “Bar-Kafe”.

Pra, këto aktive gjëndje në ambjentin ku ushtrohet aktiviteti që janë të domosdoshme për veprimtarinë e subjektit (nuk ka bar-kafe pa tavolina e karrige) nuk mund të krijojnë asnjë mundësi për shambahie të detyrimeve tatimore.

Per sa me siper gjykates i duhet te vendose per pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj si dhe shfuqizimin e pjesëshëm të Procesverbalit të Konfiskimit me nr 0014111, datë 09.09.2015 si akt i pabazuar në nenin 121 të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si edhe kthimin e shumës në vlerën 386.950 lekë e llogaritur nga Komisioni i Vlerësimit të Mallrave të Konfiskuara me Vendimin nr. 12326/1 prot., datë 10.09.2015 e cila është marrë në mënyrë të kundërligjshme.

Për Këto Arsyë

Gjykata ne baze te Ligjit Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimi i Mosmarrëveshjeve Administrative”, Ligji Nr. 9920, Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar,



VENDOSI :

1. Pranimin e kerkesepadisë si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shfuqizimin e pjesëshëm të Procesverbalit të Konfiskimit me nr 0014111, datë 09.09.2015 si akt i pabazuar në nenin 121 të Ligjit Nr. 9920, Datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".
3. Kthimin e shumës në vlerën 386.950 lekë e llogaritur nga Komisioni i Vlerësimit të Mallrave të Konfiskuara me Vendimin nr. 12326/1 prot., datë 10.09.2015 e cila është marrë në mënyrë të kundërligjshme.
4. Shpenzimet procedurale ne ngarkim te palës se paditur.
5. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
6. Ky vendim eshte i ekzekutueshem prej Zyres se Permbarimit Gjyqesor menjehere sa po vendimi te marre forme te prere.
7. Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Vlorë, sot më date 23.11.2015

SEKRETARE
KAMILA PETRITI

GJYQTAR
KEN DHIMA

